



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2022:105840  
Datë: 31.07.2024  
Numri i dokumentit: 06001182  
KPPP.nr.81/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Valvolub” SH.P.K., me NRB: 70049064, me seli në Mitrovicë, rruga “Vëllëzërit Dragaj” nr.25, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit mbi lejimin e përbarimit CP.nr.143/16 të datës 25.01.2019 të lejuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit “Valvolub” SH.P.K., ANULOHET Aktvendimi mbi lejimin e përbarimit CP.nr.143/16 i datës 25.01.2019, i lejuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Aktvendimin mbi lejimin e përbarimit CP.nr.143/16 të datës 25.01.2019, ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.216918362010 të datës 11.01.2010; Faturës Nr.214647762009 të datës 10.12.2009; Faturës Nr.208266/802009 të datës 04.11.2009; Faturës Nr.206745772009 të datës 03.10.2009; Faturës Nr.205235542009 të datës 10.09.2009; Faturës Nr.203720652009 të datës 04.08.2009; Faturës Nr.202177632009 të datës 06.07.2009; Faturës Nr.200811682009 të datës 04.06.2009; Faturës Nr.199126672009 të datës 11.05.2009; Faturës Nr.195223752009 të datës 07.04.2009; Faturës Nr.192916432009 të datës 05.03.2009; Faturës Nr.191333582009 të datës 07.02.2009; Faturës Nr.188346592008 të datës 03.12.2008 dhe Faturës Nr.189788962009 të datës 04.01.2009, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda

afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 107.84 €, me kamatë prej 3.5 %, duke llogaritur prej datës kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, me regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në pagesën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar aktvendimin mbi lejimin e përbarimit duke theksuar se borxhi i ngarkuar ndaj debitorit është joreal dhe i padrejtë, pasi që asnjëherë nuk ka pranuar fatura nga kreditori dhe nuk ka qenë i informuar se është duke u ngarkuar me borxh nga kreditori. Tutje ka shtuar se borxhi është i parashkruar sipas dispozitave të LMD-së, pasi që ka kaluar afati 1 vjeçar i parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj aktvendimin mbi lejimin e përbarimit.

Kreditori me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se borxhi është joreal dhe i padrejtë dhe se i njëjti është parashkruar, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me afatin 3 vjeçar të parashkrimit, andaj kërkesa e kreditorit është e afatshme. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se aktvendimi duhet të anulohet dhe procedura përbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat, në bazë të së cilave është lejuar ekzekutimi sipas Aktvendimi mbi lejimin e përbarimit, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par.

3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar*“, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet – Fatura Nr.216918362010 e datës 11.01.2010; Fatura Nr.214647762009 e datës 10.12.2009; Fatura Nr.208266/802009 e datës 04.11.2009; Fatura Nr.206745772009 e datës 03.10.2009; Fatura Nr.205235542009 e datës 10.09.2009; Fatura Nr.203720652009 e datës 04.08.2009; Fatura Nr.202177632009 e datës 06.07.2009; Fatura Nr.200811682009 e datës 04.06.2009; Fatura Nr.199126672009 e datës 11.05.2009; Fatura Nr.195223752009 e datës 07.04.2009; Fatura Nr.192916432009 e datës 05.03.2009; Fatura Nr.191333582009 e datës 07.02.2009; Fatura Nr.188346592008 e datës 03.12.2008 dhe Fatura Nr.189788962009 e datës 04.01.2009, në bazë të së cilave është lejuar Aktvendimi mbi lejimin e përmbardimit, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjta nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk kanë dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Andaj, duke qenë së debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, si të tilla, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilët mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilëve është lejuar përmbardimi, nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe aktvendimi i lejuar duhet të anulohet dhe procedura përmbardimore lidhur me këtë çështje të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.81/23, datë 31.07.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.